



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit**  
**Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit**

|          |  |
|----------|--|
| Data     |  |
| Nr. Prot |  |

**RELACION**

**VENDIMI**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMIT**  
**PËR TË DREJTAT E NJERIUT” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR**  
**PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Vangjel Dule, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimit për të Drejtat e

Njeriut”, me initiale “PBDNJ”, me Kryetar Z. Vangjel Dule, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” me shkronja nistore “PBDNJ”, me adresë Rruga "Norbert Jokl", përballë ish ATSH, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Vangjel Dule, me adresë Selia e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Elona Boçi, me adresë Rruga "Norbert Jokl", përballë ish ATSH, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjes për komunikim me KQZ-në është Z. Thodhori Kamberi dhe Zj. Elena Muho, me adresë Rruga "Norbert Jokl", përballë ish ATSH, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

|                         |                                                                           |
|-------------------------|---------------------------------------------------------------------------|
| <b>Licela VELIU</b>     | -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit |
| <b>Pavlina DOÇAJ</b>    | -Drejtorja e Ligjshmërisë                                                 |
| <b>Majlinda ÇELMETA</b> | -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)                       |